



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA TIRANE



## Raport Teknik

**Objekti :Rehabilitimi i rrugëve të bllokut që kufizohet nga rrugët "Fabrika e Qelqit", "Koferenca e Pezes", "Besim Alla" dhe "Jorgo Panajoti, Faza II".**





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA TIRANE  
DREJTORIA E PERGJITHSHEME E PUNEVE PUBLIKE


*RAPORTI TEKNIK*

**"REHABILITIMI I RRUGËVE TË BLOKUT QË KUFIZOHET NGA  
RRUGËT "FABRIKA E QELQIT", "KONFERENCA E PEZËS",  
"BESIM ALLA" DHE "JORGO PANAJOTI", FAZA II.**



*Projekt- Zbatim*

*Tirane 2018*



## Kapitulli i parë

### Pershkrim i pergjithshem

Zhvillimi i vendit eshte i shoqeruar me ndryshime te medha ekonomiko - shoqerore, te cilat shprehen ne rradhe te pare me kerkesat ne rritje te transportit si ate nderkombetar ashtu dhe ate te brendshem. Tipar i transportit aktual eshte fleksibiliteti, individualiteti dhe kryerja e tij nga subjekte shteterore dhe private, tipike per nje ekonomi tregu te hapur e konkruuese, te cilat dalin ne dukje ne nje shkalle me te larte ne transportin rrugor, qe natyrshem ka prioritetin ne infrastrukturen e vendit.

### Vendi dhe relievi

Republika e Shqipërisë ndodhet në Europën Juglindore në brigjet perëndimore të gadishullit të Ballkanit. Ajo shtrihet ndërmjet gjerësive veriore 39038' dhe 42039' dhe gjatësive lindore 19016' e 21040'. Largësia më e madhe ndërmjet pikës më veriore dhe asaj më jugore është 335 km dhe ndërmjet pikës më lindore dhe asaj më perëndimore 150 km.

Shqipëria e ka sipërfaqen 28.748 kilometra katrorë dhe kufizohet: nga jugu, me Greqinë; nga lindja, me FYR e Maqedonisë; nga veriu dhe veriperëndimi, me Serbinë dhe Malin e Zi; nga veriu e verilindja, me Kosovën. Nga perëndimi laget prej detit Adriatik dhe nga jugperëndimi, prej atij Jon.

Gjatësia e përgjithshme e kufirit të Shqipërisë është 1.094 km. Kufijtë tokësorë, detarë, liqenorë dhe lumore janë përkatësisht: 657 km, 316 km, 73 km dhe 48 km. Vija bregdetare është 427 km e gjatë: 273 km i përkasin bregdetit të Adriatikut dhe 154 km bregdetit të Jonit.

Tirana është kryeqendra e qarkut dhe rrethit me të njëtin emër dhe kryeqyteti i Republikës së Shqipërisë. Tirana ndodhet në qendër të Shqipërisë, rreth 35 km në lindje të Durrësit dhe rreth 40 km në veri-perëndim të Elbasanit, në një luginë e rrethuar nga Mali i Dajtit në lindje, kodrat e Kërrabës dhe Saukut në jug, kodrat e Vaqarrit dhe Yzberishtit në perëndim dhe ato të Kamzës në veri. Tirana shtrihet në koordinatat 41.33° veri dhe 19.82° lindje.

### Relievi

Qarku i Tiranës shtrihet ne pjesen qendrore te Shqiperise ne nje lartesi qe varion nga disa metra mbi nivelin e detit deri ne 1828 m, qe perfaqesohet nga maja me e larte e Malit me Gropa. Qarku ka nje territor prej 1652 km<sup>2</sup> dhe renditet i dhjeti ,persa i takon madhesis se siperfaqes ne listen e 12 qarqeve te Shqiperise.





Qarku i Tiranës, në pjesën e tij perëndimore, ka një vijë bregdetare me detin Adriatik, me gjatësi 33 km, ndërsa në veri kufizohet me Qarkun e Durrësit, në verilindje me Dibren, në juglindje me Elbasanin dhe në jug me qarkun e Fierit.

Relievi i Qarkut të Tiranës është një kombinim i larmishëm i zonës malore me zonat e uletave fushore dhe zonat bregdetare. Duke ju referuar shtrirjes gjeografike, zona malore e Tiranës është e vendosur kryesisht në verilindje, në kufi me Qarkun e Dibres dhe në pjesën juglindore, që kufizohet me Qarkun Elbasan. Në këtë pjesë gjendet edhe Parku Kombëtar i Dajtit. Ky park është i vendosur në lindje të kryeqytetit, në distancën 23 km larg dhe zë një sipërfaqe rreth 3300 hektarësh. Maja më e lartë e Dajtit arrijnë në lartësi 1612 m mbi nivelin e detit. Në Parkun Kombëtar të Dajtit, në shpatin perëndimor të malit, gjendet pjesa e quajtur Ballokoni i Tiranës që shtrihet në lartësi 1000 m mbi nivelin e detit dhe është e gjatë 2 km. Po në lartësi 1000 m mbi nivelin e detit gjendet edhe rrafshina e Bizës e cila është pjesë e Malit me Gropa. Në këtë zonë gjenden formacione /gropa karstike që krijojnë peisazhe të mrekullueshme. Në pjesën e parkut kombëtar shtrihet edhe Mali i Priskës (1353 m) që bashku me Malin e Dajtit mbulojnë një zonë prej 29216 hektarësh. Në zonën malore të qarkut të Tiranës gjenden edhe qafa e Priskës me lartësi 850 m dhe qafa e Kerrabes me lartësi 933 m mbi nivelin e detit. Zona

fushore e qarkut te Tiranes shtrihet ne pjesen jugore dhe jug-perendimore te tij,ne kufi me Qarkun e Fierit dhe ate te Durrresit.Kjo zone ndodhet kryesisht ne territorin e bashkise se Vores, Kavajes,rrogozhines si dhe ne komonat qe jane vendosur rreth ketyre bashkive.

## Karakteristikat Klimatike

**Temperatura e ajrit** - Persa i perket luhatjes brenda vitit te temperatures se ajrit duhet thene se kemi te bejme me nje regjim tipik ku temperatura minimale vrojtohet ne muajin Janar,  $6.9^{\circ}\text{C}$ , ndersa temperatura maksimale vrojtohet ne muajt Korrik dhe Gusht  $23.8^{\circ}\text{C}$ . Ne zonen tone, rendesi paraqesin gjithashtu edhe numri i diteve me temperature nen  $-10^{\circ}\text{C}$ , qe quhen dite te akullta. Ne zonen ne te cilen shtrihet objekti ne studim, temperaturat nen  $-10^{\circ}\text{C}$  jane teper te rralla. Dite te ftohta ndodhin gjate periudhes se ftohte te vitit (Nentor-Mars) ku me te shquarit jane muajt Dhjetor dhe Janar, ndersa ditet me temperature nen  $-5^{\circ}\text{C}$  jane shume te rralla dhe vetem nje dite eshte ne muajin Janar. Persa i perket temperaturave te ajrit duhet thene se zona ne studim karakterizohet nga nje klime e bute mesdhetare.

**Rreshjet atmosferike** - Faktoret qe ndikojne ne karakteristikat e reshjeve atmosferike jane ne pozicionin gjeografik, afersia me detin dhe orografia.

**Era** - Shpejtesia e eres ne territorin e zones ne studim ashtu si ne te gjithe vendin tone, eshte ne vartesi te periudhes se vitit. Vlerat me te medha te tyre vrojtohen ne stinen e dimrit kur veprimtaria ciklonare eshte e theksuar. Ne kete stine shpejtesite mesatare luhaten rreth  $1.6\text{m/s}$

**Stuhite** - Stuhite qe per vendin tone jane te shumta dhe ndodhin ne te gjithe stinet e vitit, shpesh shoqerohen me bresher. Me shume dite me bresher ka ne muajt e dimrit dhe gjysmen e vjeshtes dhe ne gjysmen e pare te pranveres. Numri me i madh i diteve me bresher vrojtohet ne rrethin e Tiranes dhe Kamez. Tirana gjate viti ka 8 dite me bresheri. Si rregull, zgjatja e breshrit eshte 3 deri 5 minuta. Gjate muajit Janar pothuajse vrojtohet mesatarisht nje dite me bresheri, Ne periudhen e ngrohte te vitit numri i diteve me bresher eshte i paket. Stuhite ne zonen ne studim mund te ndodhin ne çdo muaj, kjo tregon karakterin mesdhetar qe ka klima e zones tone. Ne thellesi te territorit te Gadishullit Ballkanik gjate periudhes se ftohte te vitit (dimrit) stuhite pothuajse nuk ndodhin fare, kjo shpjegohet me karakterin kontinental te klimes me ate rajon.

## Siguria rrugore

Aksidentet rrugore janë problemi i dytë më i rëndë i shëndetit në Shqipëri dhe situata po përkeqësohet për shkak të rritjes së shpejtë të trafikut. Përlllogaritet që edhe nëse investohen



## Gjendja ekzistuese dhe informacione te përgjithshme

Me fonde nga buxheti i shtetit në vitin 2018 e në vazhdim është planifikuar **"REHABILITIMI I RRUGËVE TË BLOKUT QË KUFIZOHET NGA RRUGËT "FABRIKA E QELQIT", "KONFERENCA E PEZËS", "BESIM ALLA" DHE "JORGO PANAJOTI", FAZA II.**

Ky objekt ndodhet në Njësinë Administrative Nr.6, ne Tirane. Blloku ndodhet në pjesën perëndimore të qytetit të Tiranës dhe kufizohet: në jug nga rruga "Konferenca e Pezës", në jug-perëndim nga "Fabrika e Qelqit", në veri- perëndim nga rruga "Jorgo Panajoti dhe në lindje nga rruga "Besim Alla" me një sipërfaqe totale prej 38 Ha. Kjo është një zonë me shumë ndërtime, të përfaqësuar me godina 1-2 dhe 5 katëshe, të ndërtuara para viteve '90 si dhe disa blloqe pallatesh të reja.

Ndërtimi i shtresave të reja rrugore, marrja e masave inxhinierike për disiplinimin sa më të mirë të ujrave, ndricimi ne rruge do bëjnë të mundur realizimin e një rruge me parametra te kënaqëshme duke lehtësuar lëvizjen e mjeteve te transportit.

### **Përshkrimi i gjendjes egzistuese sipas DST**

Rrugët kufizuese të bllokut, rruga "Konferenca e Pezës" dhe "rruga e Qelqit" janë në gjendje të mirë. Rruga "Besim Alla" me një gjatësi rreth 800ml, është e shtruar me asfalt, por në disa pjesë të saj paraqitet e dëmtuar, kunetat janë pjesërisht të dëmtuara, zgarat e të cilave janë të bllokuara. Ndërsa trotuaret janë në gjendje relativisht të mirë. Kurse rruga "Jorgo Panajoti" me gjatësi rreth 775 ml dhe gjerësi 5 - 8m, është totalisht e pasistemuar (pa shtresa asfaltike, pa trotuare, pa rrjet inxhinierik, pa rrjet ndricimi dhe gjelbërim) dhe përgjatë saj ndodhen barake që shfrytëzohen si banesa. Gjithashtu edhe degëzimet e kësaj rruge janë të pasistemuara.

Për sa i përket rrugëve të brëndshme të këtij blloku, pjesa më e madhe e tyre janë të pasistemuara dhe kanë nevojë për rikonstruksion total.

Rruga "Alqi Kondi" me gjatësi rreth 420ml, "Xhemal Ali Pazari" me gjatësi rreth 175ml, "Mehmet Shpendi" me gjatësi rreth 172 ml), "Manol Basha" me gjatësi rreth 160ml, "Kristofer Kissi" me gjatësi rreth 200ml, "Vasil Vinjau" me gjatësi rreth 190 ml) janë totalisht të pasistemuara pa shtresa asfaltike, pa trotuare, pa rrjet inxhinierik, pa rrjet ndricimi).

Ndërsa rrugë të tjera të brëndshme të bllokut janë në gjendje relativisht të mirë. Rruga "Bubulina" është e shtruar me asfalt, në të cilin vihen re dëmtime të vogla. Kurse në rrugën lidhëse të saj me "Fabrikën e Qelqit", një rrugë me gjerësi 3.5 ml dhe gjatësi 250 ml, e cila është e shtruar me asfalt, vërehet mungesa e rrjetit KUZ, KUB, mungesa e trotuareve dhe sheshet majtas dhe djathtas përgjatë rrugës janë të pasistemuara.

Rruga tjetër dalëse në "Fabrikën e Qelqit", rruga "Altin Basha" me një gjerësi 3ml dhe gjatësi 367 ml është e shtruar me asfalt, por vihet re mungesa e trotuareve.

### **Kanalizimet e ujrave të zeza**

Në këtë bllok ekziston rrjeti i K.U.Z në rrugët konturuese, ndërsa në rrugët "Jorgo Panajoti"(një nga rrugët konturuese), "Alqi Kondi", "Xhemal Ali Pazari", "Mehmet Shpendi", "Manol Basha", "Kristofer Kissi", "Vasil Vinjau" dhe "Rruga nr.7" ai mungon.

### **Kanalizimet e ujrave të bardha**

Në këtë bllok, rrjeti i K.U.B ekziston në rrugët konturuese, ndërsa në rrugët "Jorgo Panajoti"( një nga rrugët konturuese), "Alqi Kondi", "Xhemal Ali Pazari", "Mehmet Shpendi", "Manol Basha", "Kristofer Kissi", "Vasil Vinjau" dhe "Rruga nr.7" ai mungon.

### **Rrjeti ujësjellës**

Ka rrjet ujësjellësi në gjëndje relativisht të mire me perjashtim te rugeve ”Alqi Kondi” dhe “Rruga nr.7”

### **Rrjeti ndriçimit rrugor**

Në rrugët konturuese ka ndriçim rrugor, përveç rrugës ”Jorgo Panajoti”, ndërsa në rrugët e brendshme ka ndriçim rrugor në shtylla betoni me linja ajrore. Në rrugët ”Jorgo Panajoti”, ”Alqi Kondi”, ”Xhemal Ali Pazari”, ”Mehmet Shpendi”, ”Manol Basha”, ”Kristofer Kissi”, ”Vasil Vinjau”, dhe “Rruga nr.7” ai mungon.

### **Gjelbërimi**

Këto blloqe kanë sipërfaqe për gjelbërim, por ai mungon dhe në sipërfaqet e gjelbra të ndodhura shfaqet shumë i amortizuar.

### **Mobilim urban**

Në të gjithë bllokun nuk ndodhet asnjë kënd lojërash ose hapësire rekreative për banorët e zonës.

Objekt i projektit do të jetë risistemimi i rrugës, me të gjithë elementët e infrastrukturës rrugore, mobilim urban per krijimin e hapsirave dhe kende lojrash per femijet, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së komunitetit të kësaj zonë.

***Ne termat e references dhe ne detyren e projektimit na jane dhene informacionet dhe kerkesat si me poshte:***


### ***Konkretisht per rrugen:***

Rrugët e brendshme te bllokut do te trajohen me gjerësi të trupit të rrugës ekzistuese, në varësi të rëndësisë dhe të hapësirës, ndërsa rrugët perimetrale dhe ato kryesore të bllokut të trajtohen me profil minimal 2 – 6 – 2 m. Do të trajtohen trotuaret ekzistuese të bllokut dhe do të parashikohen në projekt trotuare në vendet ku hapësirat e lejojnë një gjë të tillë. Rrugët dytësore parashikohen me një krah trotuar.

Shtresat rrugore dhe të trotuarëve të trajtohen të tilla që të sigurojnë garanci, qëndrueshmëri dhe të përballojnë kapacitetet faktike dhe të prespektivës. Shtrimi i trotuarëve do të bëhet me pllaka vetështrënguese dhe me bordura të parafabrikuara. Në pjesët e ndërprerjes së trotuarëve të parashikohet ndërtimi i panduseve të kalimit në nivel rrugë – trotuar për personat me aftësi të kufizuar.



## PRERJA TIP



Gjatë hartimit të projektit është parë mundësia e ndërtimit të parkingjeve si dhe vendosja e pikave të VGM në bashkëpunim me Drejtorinë përkatëse të Bashkisë Tiranë.

Materialet që do të përdoren, do të jenë sipas kushteve teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve.

Në përfundim ne si zyre konsulente kemi pasur konsultime të vazhdueshme me Bashkinë Tiranë përpara fillimit të punës për projektin, ashtu si edhe gjatë të gjitha fazave të projektimit dhe zbatimit të tij dhe kjo si për garantimin e saktësisë së bazës së të dhënave ashtu edhe për reflektimin e ndryshimeve të pritshme nga plan/studimet.

Foto ne objekt:



**ZGJIDHJA TEKNIKE OBJEKTI:**

“Rehabilitimi i Rrugëve të Bllokut që Kufizohet nga Rrugët "Fabrika E Qelqit", "Konferenca e Pezës", "Besim Alla" dhe "Jorgo Panajoti", Faza II.

**Pershkrimi i kategorise se rruges .**

Duke iu referuar Standardeve te projektimit te rrugeve,; “Manuali Shqiptar i Projektimit te Rrugeve - MShPRr”, ku nje modul MShPRr – 2, perfshin “Projektimin Gjeometrik te Rrugeve”. Ne tabelat me poshte jane dhene treguesit kryesore te kalsifikimit te rrugeve ne studim dhe tabelat me parametrat kryesore te gjeresise, simbolit dhe emertimeve te tjera te rrugeve ne Republiken e Shqiperise.


*Ne kodin rrugor keto kategori percaktohen si me poshte:*

**Rrugë urbane lagje E- Rruga**

Rrugë me një karrexhatë me të paktën dy korsi, bankina të shtruara dhe trotuare. Për qëndrimin janë parashikuar zona të pajisura me korsi manovrimi jashtë karrexhatës.

**RRUGË E KATEGORISË E**

**RRUGË URBANE LAGJE**



### Përbërja e karrexhatës

Llojet sipas kodit		Shtirirja territoriale		Limiti i shpejtësisë	Numri i korsive për secilin drejtim	Limiti i poshtëm (km/ore)	Limiti i sipërm (km/ore)
1	2	3		4	5	6	7
AUTORRUGE	A	NDËRURBANE	Rrugë parësore	130	2 ose me shume	90	140
			Rrugë shërbimi	90	1 ose me shume	40	100
		URBANE	Rrugë parësore	130	2 ose me shume	80	140
			Rrugë shërbimi	50	1 ose me shume	40	60
NDËRURBANE PARESORE	B	NDËRURBANE	Rrugë parësore	110	2 ose me shume	70	120
			Rrugë shërbimi	90	1 ose me shume	40	100
NDËRURBANE DYTESORE	C	NDËRURBANE	C1	90	1	60	100
			C2	90	1 1	60	100
			C3	60	1 1	40	70
URBANE KRYESORE	D	URBANE	Rrugë parësore	70	2 ose me shume	50	80
			Rrugë shërbimi	50	1 ose me shume	25	60
URBANE NE LAGJE	E	URBANE		50	1 ose me shume	40	60
LOKALE	F	NDËRURBANE	F1	90	1	40	100
		URBANE	F2	90	1	40	100
				50	1 ose me shume	25	60

LLOJET SIPAS KODIT		SHTRIRJA TERRITORIALE		Gjerësia min. e ishullit të trafikut (m)	Gjerësia min. e bankinës në të majtë (m)	Gjerësia min. e bankinës në të djathtë (m)	Gjerësia e korsise se emergjences (m)	
1	2	3	8	9	10	11	12	
AUTORRUGË	A	NDËRURBANE	Rrugë parësore	3.75	2.6	0.7	2.50 *****	3
			Rrugë shërbimi	3.50 **	-	0.5	1.25	-
		URBANE	Rrugë parësore	3.75	1.8	0.7	2.50 *****	3
			Rrugë shërbimi	3.00**	-	0.5	0.5	-
NDËRURBANE PARESORE	B	NDËRURBANE	Rrugë parësore	3.75	2.50 ***	0.5	1.75	-
			Rrugë shërbimi	3.50 **	2.00 ****	0.5	1.25	-
NDËRURBANE DYTESORE	C	NDËRURBANE	C1	3.75	-	-	1.5	-
			C2	3.50	--	--	1.25	-
			C3	3.5			1.00	-
URBANE KRYESORE	D	URBAN	Rrugë parësore	3.25*	1.8	0.5	1	-
		E	Rrugë shërbimi	2.75 **	-	0.5	0.5	-
URBANE NE LAGJE	E	URBANE		3.00* **	-	-	0.5	-
LOKALE	F	NDËRURBANE	F1	3.5	-	-	1	-
			F2	3.25	-	-	1	-
		URBANE		2.75 **	-	-	0.5	-

Përbërja e karrexhatës

**Shenim:**

Në rast të një rrugë me nje korsi dhe me nje drejtim levizjeje, gjerësia e përgjithshme e korsise plus bankinën e shtruar nuk duhet të jetë më pak se 5.50 m, duke zmadhuar korsinë në një maksimum prej 3.50 m dhe kompensimi i diferencës bëhet në bankinën e shtruar djathtas

LLOJET SIPAS KODIT	SHTRIRJA TERRITORIALE		Gjeresia minimale e trotuarve (m)	Percaktimi i ndalesave	Percaktimi i transporteve publike	Rregullimi i trafikut te kembesoreve	Hyrjet	
1	2	3	17	18	19	20	21	
AUTOSTRADE	A	SUBURBANE	Rruge paresore	-	Pranohet ne hapësira te ndara me hyrje dhe dalje te perqendruara	Nuk lejohet ndalimi	Perjashtohet	Perjashtohet
			Rruge sherbimi	-	Lejohet ne hapësira te vecanta (brez i ndalimeve)	Ndalesa te organizuara ne zona te vecanta ne ane te rruges automobilistike	Ne bankine	Lejohet
		URBANE	Rruge paresore	-	Pranohet ne hapësira te ndara me hyrje dhe dalje te perqendruara	Nuk lejohet ndalimi	Perjashtohet	Perjashtohet
			Rruge sherbimi	1.50	Lejohet ne hapësira te vecanta (brez i ndalimeve)	Hapësira ndalimi ose korsi te rezervuara	Ne trotualet e mbrojtur	Lejohet
SUBURBANE PARESORE	B	SUBURBANE	Rruge paresore	-	Pranohet ne hapësira te ndara me hyrje dhe dalje te perqendruara ose ne vendet e ndalesave	Pranohet ne hapësira te ndara me hyrje dhe dalje te perqendruara	Perjashtohet	Perjashtohet
			Rruge sherbimi	-	Lejohet ne hapësira te vecanta (brez i ndalimeve)	Ndalesa te organizuara ne zona te vecanta ne ane te rruges automobilistike	Ne bankine	Lejohet
SUBURBANE DYTESORE	C	SUBURBANE	C1	-	Lejohet ne vendet e ndalesave	Ndalesa te organizuara ne zona te vecanta ne ane te rruges automobilistike	Ne bankine	Lejohet
			C2	-				
URBANE KRYESORE	D	URBANE	Rruge paresore	1.50	Pranohet ne hapësira te ndara me hyrje dhe dalje te perqendruara	Korsi e rezervuar dhe/ose ndalesa te organizuara	Ne trotualet e mbrojtur	Perjashtohet
			Rruge sherbimi	1.50	Lejohet ne hapësira te vecanta (brez i ndalimeve)	Vende per te ndaluar	Ne trotualet e mbrojtur	Lejohet
URBANE NE LAGJE	E	URBANE		1.50	Lejohet ne hapësira te vecanta (brez i ndalimeve)	Hapësira ndalimi ose korsi te rezervuara	Ne trotualet e mbrojtur	Lejohet
LOKALE	F	SUBURBANE	F1	-	Lejohet ne vendet e ndalesave	Ndalesa te organizuara ne zona te vecanta ne ane te rruges automobilistike	Ne bankine	Lejohet
			F2	-				
		URBANE		1.50	Lejohet ne hapësira te vecanta (brez i ndalimeve)	Vende per te ndaluar	Ne trotualet e mbrojtur	Lejohet

Përbërja e karrexhatës

Tabela e Shpejtesive llogaritese te levizjes

LOJET SIPAS KODIT		SHTRIRJA TERRITORIALE	EMERTIMI I RRUGEVE	Vp min [km/h]	qmax	f tmax	Reze minimale [m]
AUTOSTRADË	A	SUBURBANE	RRUGË PARËSORE	90	0.07	0.118	339
				40	0.07	0.21	45
		URBANE	RRUGË PARËSORE	80	0.07	0.13	252
				40	0.035	0.21	51
SUBURBANE PARESORE	B	SUBURBANE	RRUGË PARËSORE	70	0.07	0.147	178
				40	0.07	0.21	45
SUBURBANE DYTËSORE	C	SUBURBANE		60	0.07	0.17	118
URBANE KRYESORE	D	URBANE	RRUGË PARËSORE	50	0.05	0.205	77
				25	0.035	0.22	19
URBANE NE LAGJE	E	URBANE		40	0.035	0.21	51
LOKALE	F	SUBURBANE		40	0.07	0.21	45
		URBANE		20	0.035	0.21	19

Tabela Kufinitë e pjerrësisë tërthore, fërkimit dhe rrezet për rrugë të ndryshme

Klasifikimi i rrugës		Pjerrësia maksimale gjatësore max h [%]
Autostrada	A	5
Rruga parësore ndërrurbane/ rurale	B	6
Rruga dytësore ndërrurbane/ rurale	C	7
Rrugalokale ndërrurbane/ rurale	D	10

Duke ju referuar standarteve te projektimit dhe per te bere nje vleresim lidhur me klasifikimin e rrugeve u jemi referuar te dhenave te "Kushteve Tenike te Projektimit Gjeometrik te Rrugeve Automobilistike " ne fuqi, eshte bere klasifikimi sipas Kat.E, nga te cilat rezultojne parametrat kryesore te gjerësisë, te shtresave, bankinave, shpejtesite e projektimit ne funksion te terrenit si dhe rreztmin te kthesave e pjerrësite maksimale ne rruge.

### Shpejtësia e projektimit për rruget e kategorise E:

- $V_{min}=40$  (km/ore)
- $V_{max}=60$  (km/ore)

**Rrezet minimale: 51 m** ( $V_{proj}=40$  km/ore)

Objekti i studimit duhet parë në prespektive edhe në lidhje me projekte në ngjashme në këto zone të kryeqytetit.

*Per sa me sipër këshillojme që si shpejtësi të lejuar të levizjes të kemi 50km/ore.*

Studim Projektim objekti : "REHABILITIMI I RRUGËVE TË BLOKUT QË KUFIZOHET NGA RRUGËT "FABRIKA E QELQIT", "KONFERENCA E PEZËS", "BESIM ALLA" DHE "JORGO PANAJOTI", FAZA II u krye:

- Në përputhje me Detyrën e Projektimit të hartuar nga Bashkia e Tiranës.
- Në përputhje me Standartin Shqiptar të projektimit të rrugëve dhe të standarteve të tjera të miratuara nga institucionet shqiptare.
- Në përputhje me vendimet e mara në mbledhjet e Këshillit Teknik të fazës së Projekt Idese Paraprake dhe fazës së Projekt Idese Perfundimtare të miratuar.

Per sa me sipër do të trajtohen akset si më poshtë:


Permbajtja:

1. Rruga "Zagoria",  $L=296.39$ ml
2. Rruga "Vasil Vinjau 1,2,3", të cilat kanë një gjatësi  $V1=115.07$ ml:  $V2=114.35$ ml:  $V3=40.29$ ml
3. Rruga Nr. 8 (pjesa 2),  $L=106.85$ ml
4. Rruga "Kristofer Kisi",  $L=134.54$ ml
5. Rruga 1,2,3, të cilat kanë një gjatësi  $L1=149.83$ ml:  $L2=32.75$ :  $L3=60.24$
6. Rruga 4,5, e cila ka një gjatësi  $L4=85.99$ ml:  $L5=51.60$  ml

### 1. Rruga Zagoria

Rruga Zagoria ka nje gjatesi prej 296.39m . Kjo rruge lidh rrugen Besim Alla me rrugen Jorgo Panajoti. Kjo rruge eshte totalisht e pasistemuar (pa shtresa asfaltike, pa trotuare, pa rrjet inxhinierik, pa rrjet ndricimi dhe gjelberim). Sipas skemes te rrjetit rrugor ky segment do jete me dy sense drejtimi + vendparkim. kjo rruge do te trajtohet me keto profile tip.

Seksionet tip jane paraqitur me poshte:  
 Nga progresiva 0+000 deri ne progresiven 0+100 rruga ka kete seksion tip:



#### Parametrat e rruges jane:


- 2 x 2.5 m (korsi kalimi) + 1x1.5 m (korsi kalimi) 2 x 0.5 m (kunete) +2 x 0.15 m (bordure) + 1 x 1.8 m (trotuare variabel)
- Gjeresia e asfaltuar 6.5 m me asfaltobeton
- Kunetat 2 x 0.5 m
- Bordure 2 x 0.15 m




- Trotuare 1 x 1.8 m
- Gjerësia e trupit të rrugës 9.60 m

**Paketa e shtresave është:**

- 3 cm asfaltobeton + Emulsion bituminoz
- 5 cm binder + Emulsion bituminoz
- stabilizant 15cm
- cakll 30cm



Nga progresiva 0+100 deri ne progresiven 0+296.39 rruga ka kete seksion tip:



**Parametrat e rruges jane:**

- 2 x 2.5 m (korsi kalimi) + 2 x 0.5 m (kunete) + 2 x 0.15 m (bordure) + 1 x 1.8 m (trotuare)
- Gjerësia e asfaltuar 5 m me asfaltobeton
- Kunetat 2 x 0.5 m
- Bordure 2 x 0.15 m
- Trotuare 1 x 1.8 m
- Gjerësia e trupit te rruges 8.10 m

**Paketa e shtresave eshte:**

- 3 cm asfaltobeton + Emulsion bituminoz
- 5 cm binder + Emulsion bituminoz
- stabilizant 15cm
- cakell 30cm

## 2.Rrugicat nr 1,2,3,4,5

Parashikohet sistemimi I rrugicave te brendshme te lagjes te cilat jane totalisht te pasistemuara, pa shtresa asfaltike, pa rrjet inxhinierik, pa rrjet ndriçimi. Gjithesej sistemohen keto rrugica:

**1 Rruga nr 1** me gjatesi 149.83m lidh rrugen Besim Alla me rrugen Jorgo Panajoti dhe eshte vazhdim i nje rruge te bllokut perballe qe po sistemohet. Do te ket 2 korsi nga 2.5 m. Ne karhun e djathte kufizohet nga muret rrethuese te shtepive, ndersa ne krahun e majte mbeshtet mbi je mur mbajtes ekzistues, i cili eshte ne gjendje te mire. Kjo rruge do te trajtohet me:

- Paketen e shtresave rrugore (per rruget e brendshme)
- Ndricim
- Kanalizime te ujrave te bardha dhe te zeza
- Sinjalistike horizontale dhe vertikale

**2 Rruga nr 2** me gjatesi 32.75 m dhe gjeresi 3 m do te sherbeje si rruge hyrese ne oborr pallati. Ne fund te rruges parashikohet edhe sistemimi i sheshit.

**3 Rruga nr 3** me gjatesi 63.24 m dhe me gjeresi 5 m. Kjo eshte rruge hyrese ne lagje dhe nepermjet saj mund te aksesohet tek rruga Jorgo Panajoti. Momentalisht ne krahun e djathte te saj rruga mbeshtet tek nje mur mbajtes i cili ka pesuar carje dhe lind nevoja e ndertimit te nje muri te ri. Korsia e djathte perdoret per levizje kurse korisa e majte perdoret per vendparkim. Do te sistemohet sheshi i perbashket i disa pallateve pasi verehet qe ne kohe rreshjesh ka permbytje te tij. Per sa me siper rruga do te trajtphet me:

- Paketen e shtresave rrugore (per rruget e brendshme)
- Kanalizime te ujrave te shiut
- Sinjalistike

**4 Rruga nr 4** me gjatesi 85.99 m, ne pjesen e pare te saj perbehet nga 2 korsi kalimi me nga 2.5 m secila dhe vendparkim ne te dy krahet nga 2 m. Ne pjesen e dyte perbehet nga dy korsi kalimi nga

2.5 m secila. Do te trajtohet me:

- Paketen e shtresave rrugore (per rruget e brendshme)
- Kanalizime te ujrave te shiut
- Sinjalistike

**5 Rruga nr 5** me gjatesi 51.60 m, rruge lagje me gjeresi 4 m do te trajtohet me:

- Paketen e shtresave rrugore (per rruget e brendshme)
- Kanalizime te ujrave te shiut
- Sinjalistike




### 3.Rruga "Vasil Vinjau"

Rruga "Vasil Vinjau 1, 2, 3" është e ndare në tre segmente, segmenti parë me gjatësi 115.07m është rrugë lidhëse e lagjes me rrugën "Besim Alla".

Segmenti i dytë me një gjatësi 114.35 m lidh rrugën "Alqi Kondo" me rrugën "Zagaria dhe është popozuar sipas gjërësive ekzistuese. Segmenti nr 3 me gjatësi 40.29 m është rrugë lidhëse e lagjes me rrugën Alqi Kondi. Këto segmente kanë një gjërësi 4-5 m, dhe janë totalisht të pasistemuar (pa shtresa asfaltike, pa trotuare, pa rrjet inxhinierik, pa rrjet ndriçimi dhe gjelbërim). Sipas skemës të rrjetit rrugor segmenti nr 2 dhe nr 3 do jenë vetëm me një sens drejtimi, pasi gjendja ekzistuese nuk e lejon zgjerimin e kurores së rrugës.

Seksioni tip i segmentit te pare eshte paraqitur me poshte:

Nga progresia 0+000 deri ne progresiven 0+115.07 (segmenti pare) rruga ka kete seksion tip:




**Parametrat e rruges jane:**


- 1 x 4 m (korsi kalimi) + 1 x 0.5m (kunete) + 2 x 0.15m (Bordure)+ 1 x 1 (Trotuare)
- Gjeresia e asfaltuar 4 m me asfaltobeton
- Kunetat 1 x 0.5 m
- Bordura 2 x 0.15 m
- Trotuar 1 x 1 m
- Gjeresia e trupit te rruges 5.8 m

**Paketa e shtresave eshte:**

- 3 cm asfaltobeton + Emulsion bituminoz
- 5 cm binder + Emulsion bituminoz
- stabilizant 15cm
- cakell 30cm



Nga progresia 0+000 deri ne progresiven 0+114.35,



Parametrat e rruges jane:

- 1 x 4 m (korsi kalimi) + 1 x 0.5m (kunete) + 2 x 0.15m (Bordure) + 2 x 1m (Trotuare)
- Gjeresia e asfaltuar 4 m me asfaltobeton
- Kunetat 1 x 0.5 m
- Bordura 2 x 0.15 m
- Trotuare 2 x 1 m
- Gjeresia e trupit te rruges 6.8 m

Paketa e shtresave eshte:

- 3 cm asfaltobeton + Emulsion bituminoz
- 5 cm binder + Emulsion bituminoz

Raport Teknik





- Gjerësia e trupit të rruges 4.8 m


Paketa e shtresave është:

- 3 cm asfaltobeton + Emulsion bituminoz
- 5 cm binder + Emulsion bituminoz
- stabilizant 15cm
- cakell 30cm

#### 4. Rruga nr 8 (pjesa 2)

Rruga "nr 8" ka një gjatësi prej 106.85 m. Kjo rrugë lidh rrugën nr 7 me rrugën Jorgo Panajoti. Kjo rrugë është totalisht e pasistemuar (pa shtresa asfaltike, pa trotuare, pa rrjet inxhinierik, pa rrjet ndriçimi dhe gjelbërim). Sipas skemes të rrjetit rrugor ky segment do të jetë me dy sense drejtimi + vendparkim. Kjo rrugë do të trajtohet me disa profile tip.

Nga progresiva 0+300 deri në progresivën 0+406.85 (PJESA 2) rruga ka këto seksion tip:




#### Parametrat e rruges janë:

- 2 x 2.5 m (korsi kalimi) + 2 x 0.5 m (kunete) + 2 x 0.15 m (bordure) + 1 x 1.5 m (trotuare variabel)
- Gjerësia e asfaltuar 5 m me asfaltobeton
- Kunetat 2 x 0.5 m
- Bordure 2 x 0.15 m
- Trotuare 1 x 1.1.5 m
- Gjerësia e trupit të rruges 7.80 m



**Paketa e shtresave eshte:**

- 3 cm asfaltobeton + Emulsion bituminoz
- 5 cm binder + Emulsion bituminoz
- stabilizant 15cm
- cakell 30cm




**5. Rruga Zagoria**

Rruga Zagoria ka nje gjatesi prej 863.04ml . Kjo rruge lidh rrugen Besim Alla me rrugen Jorgo Panajoti. Kjo rruge eshte totalisht e pasistemuar (pa shtresa asfaltike, pa trotuare, pa rrjet inxhinierik, pa rrjet ndriçimi dhe gjelbërim). Sipas skemes te rrjetit rrugor ky segment do jete me dy sense drejtimi + vendparkim. kjo rruge do te trajtohet me keto profile tip.

Seksionet tip jane paraqitur me poshte:

Nga progresiva 0+000 deri ne progresiven 0+375 0+400 deri ne 0+863.40 rruga ka kete seksion tip:




#### Parametrat e rruges jane:


- 2 x 2.5 m (korsi kalimi) + 2 x 0.5 m (kunete) + 2 x 0.15 m (bordure) + 2 x 1.8 m (trotuare variabel)
- Gjeresia e asfaltuar 5 m me asfaltobeton
- KUNETAT 2 x 0.5 m
- Bordure 2 x 0.15 m
- Trotuare 2 x 1.8 m
- Gjeresia e trupit te rruges 9.90 m

#### Paketa e shtresave eshte:

- 4 cm asfaltobeton
- 6 cm binder
- stabilizant 15cm
- cakell 30cm



Nga progresiva 0+375 deri ne progresiven 0+400 rruga ka kete seksion tip:



**Parametrat e rruges jane:**


- 2 x 2.5 m (korsi kalimi) + 1x1.5m (vendparkim) 2 x 0.5 m (kunete) +2 x 0.15 m (bordure) + 2 x 1.8 m (trotuare)
- Gjeresia e asfaltuar 5 m me asfaltobeton
- KUNETAT 2 x 0.5 m
- Bordure 2 x 0.15 m



- Trotuare 1 x 1.8 m
- Gjerësia e trupit të rruges 8.10 m

**Paketa e shtresave është:**


- 4 cm asfaltobeton
- 6 cm binder
- stabilizant 15cm
- cakell 30cm



## 6.Rruga “Kristofer Kresi”

Rruga "Kristofer Kresi" ka nje gjatesi prej 134.54 m , ky segment fillon nga rruga “Thoma Koxhaj” dhe perfundon ne rrugen “Jorgo Panajoti”. Ky segment ka nje gjerësi 3-4m, është totalisht e pasistemuar (pa shtresa asfaltike, pa trotuare, pa rrjet inxhinierik, pa rrjet ndriçimi dhe gjelbërim). Sipas skemes te rrjetit rrugor ky segment do jete vetem me nje sens drejtimi, pasi gjendja ekzistuese nuk e lejon zgjerimin e kurores se rruges. Seksioni tip eshte paraqitur me poshte:

Nga progresia 0+000 deri ne progresiven 0+134.54 rruga ka kete seksion tip:



### Parametrat e rruges jane:


- 1 x 2.5 m (korsi kalimi) + 1 x 0.5m (kunete) + 2 x 0.15m (Bordure) + 1 x 1.5(trotuar variabel)
- Gjerësia e asfaltuar 2.5 m me asfaltbeton
- Kunetat 1 x 0.5 m
- Bordura 2 x 0.15m
- Trotuare 1 x 1.5 m
- Gjerësia e trupit te rruges 4.80 m

**Paketa e shtresave eshte:**

- 3 cm asfaltobeton + Emulsion bituminoz
- 5 cm binder + Emulsion bituminoz
- stabilizant 15cm
- cakell 20cm

**Gjate punes projektuese ne rrugët e siper permendura u konstata qe:**

-Do te kete prishje kryesisht mureve rrethuese te shtepive, te cilat do te rindertohet sipas detajit (te paraqitur meposhte)




-Do të ndërtohet rrjet I kanalizimeve te ujërave të zeza në të gjithë gjatësinë e rrugës per te gjitha rrugët e siper permenduara.

Kolektori do të ndërtohet pergjate aksit te rrugës. Pusetat Kuz ndodhen ne aks te rruges, kurse Kush nga të dyja anët e rrugës do të shërbejnë si pika shkarkimi për objektet ekzistuese dhe për ato që do të ndërtohen në prespektivë. Ndërtimi i pusetave anësore do të evitonte cdo ndërhyrje në rrugën e re të cilat do të dalin si të domosdoshme nga ndërtimet e reja apo dhe atyre ekzistuese. Pusetat do te vendosen ne nje distance prej 50 m larg njera tjetres.

**PUSETE TIP D=150cm**

PER TUBA Ø 1000-1200mm (THELLESIA ME E MADHE SE 2,5m)



Qyteti i Tiranës kohët e fundit ka pësuar ndryshime të dukshme në drejtim të shtrirjes së ndërtimeve duke ndjekur dy drejtime kryesore të cilat, në funksion të zhvillimit të tyre kanë sjellë probleme në rrjetin e kanalizimeve. Si drejtim i parë është rritja e intensitetit të ndërtimeve në zonat ekzistuese të ndërtimit dhe drejtimi i dytë është zhvillimi i ndërtimeve në zona pothuaj të pa zhvilluara më parë. Të dy rastet sjellin si rezultat rritjen e sasive të ujrave të zeza dhe ujrave të shiut respektivisht për shkak të rritjes së konsumit të ujit në zonë dhe rritjes së rrjedhës së ujrave të shiut.

Ky bllok, shtrihet në një zonë me rritje të intensitetit të ndërtimeve dhe ka nevojë për rritjen e kapacitetit të rrjetit të KUZ.


Të nisur nga sa më sipër gjatë hartimit të projekt-zbatimit:

- Eshte marr në konsideratë perespektiva 20 vjeçare e rritjes së popullsisë.
  - Eshte marr në konsideratë ruajtja e rrjetit ekzistues që ka kapacitetin e mjaftueshëm përcjellës dhe është në gjendje të mirë punë. Informacion më i detajuar eshte marr pranë Sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Tiranë.
  - Drejtimi i zhvillimit urbanistik të zonës eshte marr në Bashki.
- Eshte marr parasysh “Studimi i Planit të Zhvillimit të Sistemit të Kanalizimeve” kryer nga firma “JICA” dhe studimet pjesore të miratuara në zonën në fjalë.

**Sasite e ujit që derdhen në sistemin e kanalizimeve.**

Për sasitë e ujrave të zeza që derdhen në sistemin e kanalizimeve janë përdorur të dhënat e rekomanduara në studimin për kanalizimet e qytetit Tiranë nga firma Japoneze si më poshtë:

Qmes dit= 194 l/ditë/banore



$Q_{max\ or} = 437\ l/ditë/banore$

Për sasitë e ujrave të shiut janë përdorur të dhënat e Institutit Hidrometeorologjik dhe mënyra e llogaritjes do të paraqitet nga projektuesi në mënyrë të argumentuar.

### Siguria Llogaritëse.

Siguria llogaritëse e ujrave të shiut janë llogaritur 25 % për kolektorët kryesore dhe 40 % për kolektorët sekondarë.


Vlera e llogaritjes së shiut është marr për periudhë përsëritje 1 herë në vit dhe kohëzgjatje prej 15 minutash. Intensiteti për Tiranën është 150-170litra/sek/ha e cila del me llogaritje.

Materiali kryesor ndërtimor, për kanalizimin është përdorimi i tubave prej politileni të brinjëzuar të llogaritura për të përballuar ngarkesat ose tubacione betoni me gota, pusetat dhe nënobjektet e tjera janë me material betoni të armuar duke eliminuar përdorimin e materialit të tullës në sistemin e kanalizimeve që ka rezultuar me probleme..


Për rrjetin e kanalizimeve të ujërave të shiut janë përdorur puseta betoni me zgarë me material kompozit.

Tubacioni I KUZ është projektuar me tuba betony te parapregatitur me diamer  $\varnothing 800$  dhe  $\varnothing 400$ .


**Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të bardha** është projektuar të ndërtohet komplet i ri. Është projektuar që pusetat e ujrave të shiut të vendosen çdo 25 m dhe tubacioni do të jetë me diameter Dn  $\varnothing 315$  mm.








Tubacioni i ujrave te shiut eshte projektuar dhe pranuar me tuba te brinjezuar me diameter Ø 315 mm meqenese distanca e rrugeve qe do te derdhen ujrart e shiut jane te shkurtra.



### PROFIL TIP K.U.SH 1



### Ndriçimi rrugor

Për rrugët e sipër permendura “Kristofer Kissi” “Vasil Vinjau”, Rruga nr 8, Rruga “Zagoria” Rruga “Jorgo Panajoti” Rrugica nr 3 ndriçimi rrugor është projektuar i ri.

Në rrugë me gjerësi deri në 9m është parashikuar vendosja në njërin krah e shtyllave të reja metalike me lartësi  $H=7.8m$  dhe me spesor  $\delta=4mm$

Kokat e ndriçuesave janë me gradë të lartë rezistence dhe me reflektor alumini me luçidim të lartë i paoksidueshëm, i cili bën në një masë shumë të lartë pasqyrimin e dritës. Hapja dhe mbyllja e xhamit të ndriçuesit lejon një çmontim të shpejtë gjatë mirëmbajtjes. Llampat e ndriçimit janë projektuar LED me fuqi 150 Wat deri 250 ëat.

Linja është projektuar me trase nëntokësore ku është vendosur tub plastik fleksibël me dy shtresame

$\varnothing=90mm$  për kalimin e kabllit të furnizimit dhe tub metalik me  $\varnothing=110 mm$  për intersektim rruge.


Pusetat janë prej betoni me përmasa brenda përbrenda 40x40x40cm me kapak gize. Distanca

ndërmjet pusetave është 25 m larg njëra tjetrës dhe janë vendosur mbrapa çdo shtylle për tu mbrojtur nga dëmtimet e makinave. Panelet e komandimit janë vendosur me komandim sauteri me fotoelementë.

Është parashikuar dalje energjie në puseta të veçanta për zonat e gjelbëra.

Furnizimi me energji i rrjetit të ndriçimit do të bëhet nga kabinat egzistuese të zonës. Në këto kabina duhet të instalohen panelet e ndriçimit rrugor të cilat do ushqehen me ura të veçanta nga transformatori egzistues. Në kabinë do parashikohet dhe vendosja e matësve të energjisë. Është parashikuar tokëzimi i shtyllave të ndriçimit. Është paraqitur edhe skema e furnizimit me energji elektrike për ndriçimin rrugor.

Jane respektuar normat Europiane të performances së ndriçimit EN 13201: Ndriçuesit janë projektuar me kontroll smart në mënyrë që të rregullohet intensiteti i ndriçimit sipas orëve dhe fluksit të përdorimit të rrugës. Përzgjedhja e normës së ndriçimit sipas PD CEN/TR 13201-1:2014. Është përcaktuar performanca e ndriçimit sipas përdoruesve të rrugës (Makina, Bicikleta, Këmbësor). Jane përcaktuar indikatorët e performancës së energjisë 1. treguesi i densitetit të fuqisë metrike (PDI) DP (i matur në  $\text{E}/(\text{lx} \cdot \text{m}^2)$ ) dhe treguesit vjetor të konsumit të energjisë (AECI) DE (të matur në  $(\text{Eh})/\text{m}^2$ ). Është përcaktuar lloji i rrugës sipas standartit EN 13201 Urbane, Rurale, Parësore, Dytësore, dhe në këto mënyrë është përcaktuar edhe lloji dhe intensiteti i ndriçimit. Jetëgjatësia e ndriçuesit Led sipas standartit IEC 62722-2-1. Është përcaktuar temperatura e ndriçimit sipas standartit nga 2500 deri 5000 Kelvin, në mënyrë që të evitohet efekti I ndotjes (light pollution) janë përcaktuar termat e sigurisë, mbrojtja nga tensioni, nga lageshtia etj.




### Rrjeti Internet-Telefonisë

Do të ndërtohet rrjeti i tubacioneve shpërndarëse të internet – telefonisë, sipas standarteve të përcaktuara dhe është marrë në konsideratë numri i operatorëve operues në zonë, numri i komunitetit përftues, si dhe zhvillimi në prespektivë të këtij shërbimi, për një periudhë kohore 10 vjeçare.


Ky rrjet do shtrihet në të gjithë akset rrugore kryesore dhe sekondare si dhe ka ndërlidhje me rrjetin ekzistues në zonat kufizuese rreth bllokut (ajror ose nëntokësore). Rrjeti i tubacioneve shpërndarëse të internet – telefonisë do të ndërtohet sipas standarteve të përcaktuara duke marrë në konsideratë :

- Numrin e operatorëve operues në zonën përreth,
- Numrin e komunitetit përftues
- Zhvillimin në prespektivë të këtij shërbimi për një periudhë kohore 10 vjeçare.

Ne rrugët “Kristofer Kissi” “Vasil Vinjau, Rruga nr 8, Rruga “Zagoria” Rruga “Jorgo Panajoti” Rrugica nr 3 është projektuar rrjeti i ri.




**Gjelberimi:** eshte parashikuar trajtimi I hapsirave te krijuara ne afersi te rruges me gjelberim dhe mobilim urban.




**TROTUARET:** gjeresia minimale e trotuarit eshte 1-2m, por ne varesi te objekteve dhe mureve rrethuese kemi parashikuar trotuare dhe me te gjera. Trotuari do te shtrohet me

pllake trotuari, me nenshtrese betoni (6 cm) zhavor (7 cm) dhe cakell (20 cm) si me poshte:



Pllaka trotuari 6cm  
Rere 3cm  
Zhavorr 7 cm  
Cakell 20 cm

**Vende Parkimi** Pergjate gjithë bllokut që kufizohet nga rrugët "Fabrika e Qelqit", "Konferenca e Pezës", "Besim Alla" dhe "Jorgo Panajoti" janë parashikuar vende të mjaftueshme të parkimit në ato zona ku gjeresia e rruges na e mundeson.




### **Elementet e mobilimit urban**

Një vëmendje të veçantë në projekt, i është kushtuar edhe elementëve të mobilimit urban që janë propozuar të përdoren në të gjithë bllokun e banimit, si përgjatë rrugëve ashtu edhe në hapësirat urbane, të tilla si: stola, kosha të mbeturinave, vendin e vendosjes së konteinerëve dhe të largimit publik të mbeturinave, zgara apo rrethime të pemëve, kangjella kufizuese në trotuare si dhe bllokues të mjeteve në trotuare, zgarat për bicikletat, perkatesisht në rrugët: Besim Alla, Thoma Koxhaj, Alqi Kondi -Luigj Shala dhe Rruga nr.7.

### **Detaje Stoli**

**Stol**



**Sinjalistika ne fazen e projekt zbatimit**

Sipas Detyres se Projektimit eshte hartuar planimetria e sinjalistikes me te gjitha tabelat e nevojshme informuese, lajmeruese , urdheruese etj.

TREKENDESH: E KUQE REFLEKTUESE  
 SFONDI: I ZI  
 SIMBOL: E BARDHE REFLEKTUESE

TRIANGLE: RED REFLECTIVE  
 BACKGROUND: WHITE REFLECTIVE  
 SYMBOL: BLACK



**SHENJA NDALUESE  
 PROHIBIT SIGN**


SHENJAT PER KUFIRIN E SHPEJTESISE DHE NDALIM PARAKALIMIN  
 SPEED LIMIT SIGN & OVERTAKE PROHIBIT

RRETHI: E KUQE REFLEKTUESE  
 SHENJA: E ZEZE REFLEKTUESE

CIRCLE: RED REFLECTIVE  
 SIGN: BLACK REFLECTIVE




**SHIGJETAT TREGUESE TE RRUGES  
 ROAD MARKING ARROWS**



**DHENIE PERPARESIE  
 GIVE WAY ROAD SIGN**



Shenje e ishujve te trafikut



**Vijat e bardha**

Ne planimetrine e rruges jane percaktuar dhe panduset ku do te kalojne kembesoret per te pershkruar rrugen nga njera ane ne tjetren. Vijat e bardha jane shoqeruar me sinjalistike perkatese (shenja lajmeruese).

